**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 20.10.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arta Dade – kryetare e Komisionit**

**(Procesverbal i mbajtur me shënime)**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i Kalendarit të punimeve të Komisionit për Politikën e Jashtme 20 tetor -5 nëntor;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit;
3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet RSH, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, "Përfituesi", e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, "Agjencia Zbatuese e Projektit", dhe KFË Frankfurt AM MAIN, "KFË" për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale";
4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së RSH dhe Qeverisë së Japonisë, për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhme, miqësore ndaj mjedisit";
5. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së konsulencës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare";
6. Çështje të tjera

**Marrin pjesë:**

Arta Dade, Aldo Bumçi, Namik Dokle, Valentina Leskaj, Perparim Spahiu, Vangjel Dule, Luljeta Arapi, Eduard Selami, Kastriot Islami.

**Mungojnë*:***

Edlira Çekrezi, Ben Blushi, Jozefina Topalli, Shpëtim Idrizi.

**Të ftuar:**

1. Z. Blendi Bushati, Drejtor i Departamentit te Zhvillimit Rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
2. Z. Leonard Miloti, Përgjegjës i Njësisë se Projekteve Hidroteknike, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
3. Brikena Jazxhi - Specialiste, Ministria e Financave
4. Elona Mistrovica - Specialiste, Ministria e Financave;
5. Altina Qirjazi- Drejtoria e Shërbimeve Administrative pranë Kryeministrisë
6. Znj Pranvera Kastrati me detyre Përgjegjëse Sektori Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
7. Znj Borana Kalemi me detyre Specialiste Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
8. Z. Armand Skapi, Drejtor i Drejtorisë se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme
9. Z. Refik Golli, Specialist, Drejtoria se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme

## HAPET MBLEDHJA

**Arta Dade**: Mirëdita. Nisim mbledhjen e rregullt të Komisionit për Politikën e Jashtme me këtë rend dite:

Miratimi i Kalendarit të punimeve të Komisionit për Politikën e Jashtme 20 tetor -5 nëntor;

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit;

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet RSH, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, "Përfituesi", e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, "Agjencia Zbatuese e Projektit", dhe KFW Frankfurt AM MAIN, "KFW" për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale";

Për projektligjin e parë janë të pranishëm:

Z. Blendi Bushati, Drejtor i Departamentit te Zhvillimit Rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Z. Leonard Miloti, Përgjegjës i Njësisë se Projekteve Hidroteknike, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Znj. Brikena Jazxhi - Specialiste, Ministria e Financave

Znj. Elona Mistrovica - Specialiste, Ministria e Financave;

Z. Armand Skapi, Drejtor i Drejtorisë se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme

Z. Refik Golli, Specialist, Drejtoria se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme

Projektligji i dytë "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së RSH dhe Qeverisë së Japonisë, për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhme, miqësore ndaj mjedisit";

Projektligji tretë "Për ratifikimin e marrëveshjes së konsulencës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare";

Çështje të tjera

Nisim me pikën e parë, Miratimi i Kalendarit të punimeve të Komisionit për Politikën e Jashtme 20 tetor -5 nëntor.

Sikurse jeni njoftuar nesër kemi një tjetër mbledhje të Komisionit për Politikën e Jashtme, për të marrë informacion rreth përgatitjeve dhe masave që qeveria Shqiptare ka marrë për adresimin e çështjes së azilkërkuesve në Gjermani. Masa këto edhe në bashkëpunim

diplomatik midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Shqipërisë, por gjithashtu masa të marra nga Ministria e Brendshme lidhur me mundësinë apo situatën e re që mund të krijohet nëse Shqipëria do të përgatitet për të pritur refugjatë që vijnë nga zonat e konfliktit. Gjithashtu masat që janë marrë për të ri integruar ata shqiptarë që kanë shkuar në Gjermani për të kërkuar azil. Besoj kjo ishte e domosdoshme pas takimeve që delegacioni i Komisionit për Politiken e Jashtme beri në Bundestag, dhe një nga çështjet që ne kemi diskutuar ishte edhe ky problem.

Kush është dakord me kalendarin e punimeve? Kundra? Abstenim? Miratohet.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit. Keni vërejtje? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet.

Atëherë nisim me Projektligjin e parë "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet RSH, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, "Përfituesi", e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, "Agjencia Zbatuese e Projektit", dhe KFW Frankfurt AM MAIN, "KFW" për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale";

I jap fjalën Z. Blendi Bushati, Drejtor i Departamentit të Zhvillimit Rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

**Blendi Bushati**: Faleminderit zonja Kryetare, të nderuar deputetë, ky projektligj që propozohet sot është në kuadër më të gjerë të programit të financimit të ujësjellësve rural 3, i mbështetur nga KFW, Bashkimi Europian dhe granti i sotëm nga kuadri i investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Të gjitha pjesët e tjera, komponentë të tjerë të programit janë miratuar edhe në këtë Komision e më pas në Parlament dhe marrëveshja e kredisë dhe marrëveshja me grantin me KFW për masat shoqëruese, kjo është pjesa e fundit që plotëson paketën e financimit.

Është një grant nga kuadri i investimit të Ballkanit Perëndimor në shumën 670 000 euro, një grant për të mbuluar shërbimet e konsulencës për hartimin e studimeve të fizibilitetit për ujësjellësit rural që do të financohen.

Qëllimi kryesisht i kësaj konsulence dhe i këtij granti është për të përgatitur fizibilitetin me karakter social, ekonomik, financiar dhe teknik për skemat.

Dy janë objektivat më specifik njëri i lidhur drejtpërdrejt me projektin, do të përzgjidhen ato projekte të cilat do të mbështeten për financim si dhe të kemi një pasqyrë sa më të qartë të kostos para se të hymë në angazhime të tjera për marrëveshje investimi me bashkitë për të financuar projektet. Është diskutuar dhe me donatorin, me KFW, që detajimi i kritereve dhe i procesit mbi të cilin do të zhvillohet e gjithë kjo punë do të jetë si pjesë fillestare e zyrës së

konsulentit, megjithatë në marrëveshjen në parim me KFW është rënë dakord për një proces të hapur, transparent, të gjitha bashkitë do të njihen me kriteret e këtij programi dhe do të aplikojnë, dhe pastaj ky konsulent në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit do të aplikojë disa kritere për hartimin e fizibiliteteve. Të ketë të paktën një bashkëfinancim prej të paktën 10% te njësive vendore që do jenë përfituese të skemës, kontribut lokal. Një kosto financiare jo më shumë se 350 euro për banor të investimit për të shkuar në projekte që janë më fizibël, te fshatrat që kanë një numër popullsie të përhershme më të madhe me një kufi minimal, si dhe zona e ndërhyrjes e gjithë projektit do të jetë në të gjithë Shqipërinë, pra është e hapur do të priten aplikime nga të gjitha bashkitë e vendit. Ideja është që në bazë të propozimeve që do të vijnë nga bashkitë vendosjes së këtyre kritereve, aplikimi i këtyre kritereve për përzgjedhjen e projektit do të arrihet tek ato projekte që janë si të thuash më të vlefshëm për financim.

Vlen për tu theksuar, sidomos nga përvojat e kaluara me financim nga KFW, kjo është një listë dinamike në kuptimin që një projekt mund të jetë aty për financim, por nëse për një arsye apo për një tjetër njësia e qeverisjes vendore nuk arrin të garantojë detyrimet e veta, bashkë financimin, probleme të ndryshme me karakter social, për të gjitha ato bashki që nuk janë në gjendje të mbulojnë pjesën e vet të kontratës kalohet tek projekti që është më poshtë në listë e kështu me radhë deri sa arrihet paketa e plotë e financimit.

**Arta Dade**: Përfaqësuesja e Ministrisë së Financave keni diçka për të shtuar?

**Elona Mistrovica**: bëhet fjalë për një grant në shumë 670 000,  kemi kaluar më përpara një hua 24 milion, dy grante të cilat kanë qenë një me KFW 1.5 milion masat shoqëruese të programit dhe një grant IPA 9.8 milion. Duke plotësuar paketën në total që është 40 milionë.

**Arta Dade**: Zoti Skapi:

**Armand Skapi**: Faleminderit zonja Kryetare! Të nderuar deputetë,

Projektligji që i paraqitet sot kuvendit vjen në zbatim të nenit 121 pika ç) e Kushtetutës. Në bazë të nenit 5 të marrëveshjes pala shqiptare si përfituese e grantit do mbulojë detyrimet doganore, taksat, përbëjnë detyrim financiar për Republikën e Shqipërisë, në bazë të këtij neni të Kushtetutës kjo marrëveshje i kalon për ratifikim Kuvendit.

**Arta Dade**: Faleminderit! Kolegë pyetje?

**Aldo Bumçi**: Faleminderit! ju vini me një grant studime fisibiliteti. Çfarë do të thotë me këto studime edhe nëse i kishit lekët dje nuk i investonit dot sot se nuk keni studime. Si vihet vitin e tretë të qeverisjes për të bërë studimet e fizibilitetit? Ai duhet të bëhet vitin e parë dhe ndërkohë 40 milionëshi të investohet. Nuk mund të hidhet asnjë fond pa përfunduar studimet. Studimet marrin kohë. Ju vini sot që të miratohet në Kuvend, do hyjë në fuqi, do fillojnë të

bëhen studimet, kur do aplikohen projektet? Ku është programi për furnizimin me ujë të pijshëm i qyteteve dhe fshatrave të Shqipërisë? Kur ju vitin e tretë të qeverisjes ju shkon mëndja për të bërë studimet e fizibilitetit? Të vish vitin e tretë për studime do të thotë që nuk mund të investosh. Investimet mbeten në letra sepse nuk ke studime. Nëse është ndryshe ju lutem kam gjithë dëshirën për t'ju dëgjuar.

**Arta Dade**: Zoti Bumçi unë mendoj që me logjiken tuaj pasi të mbarojnë të gjithë projektet e studimeve i bie që kujtdo që t'i bie radha të qeverisë 8 vjet duhet të bëjë studimet e fizibilitetit dhe pastaj të fillojë të kërkojë mbështetje financiare. Unë them që çdo qeveri, çdo strukturë punon paralelisht, ashtu sikurse ka ndodhur edhe në qeveritë paraardhëse dhe besoj që kur ke projektet gati kjo s'do të thotë që s'mund të marrësh më investime të tjera sepse s'ke studime fizibiliteti. Studimet kalojnë paralelisht.

**Blendi Bushati**: paketa e financimit e gjithë programit ka qenë e qartë që në fillim. Komponentë të ndryshëm kanë kaluar si marrëveshje të veçanta, por ka qenë e qartë që në fillim që e gjitha do të shoqërohej me një grant nga kuadri i investimeve të Ballkanit Perëndimor për financimin e studimit të fizibilitetit. Kjo e dakordësuar që herët me donatorin e projektit, KFW për të shtuar sa më tepër transparencë dhe profesionalizëm procesit të përzgjedhjes së projekteve dhe për të patur projekte të pranueshme nga pikëpamja financiare si dhe nga pikëpamja teknike dhe ekonomike. Ne kemi një përvojë të bashkëpunimit me KFW për zbatimin e projektit të ujësjellësve rural, një përvojë që mendojmë se ka qenë e mirë dhe që ka treguar se ujësjellësi ka një veçanti që ne duhet të jemi shumë të sigurtë që ai operohet, mirëmbahet dhe menaxhohet në mënyrë të kujdesshme pas financimit, është nga llojet e projekteve që nuk mjafton vetëm rezultati parë por duhet të jetë dhe e sigurt që strukturat janë të gatshme. Një nga kriteret që është dhe pjesë e studimit është dhe performanca e Bashkive apo e shoqërive që në të kaluarën të kenë treguar që janë të afta të menaxhojnë. Kjo ka qenë pjesë e marrëveshjes që në fillim. Duke ardhur nga kuadri i investimit të Ballkanit Perëndimor mekanizmi i investimit është i tillë që menaxhohet pjesërisht nga BERZH, BERZH duhet të arrijë marrëveshjen me KFW, pastaj e gjitha duhet të vijë për miratim tek qeveria, ndoshta prandaj është pak me vonesë. Megjithatë në krahasim me paketën tjetër financiare, kemi proceduar me kryerjen e procedurave të tenderit që në momentin që është bërë efektive marrëveshja e qeverisë dhe jemi në fazën finale. Në momentin që do të ratifikohet jemi gati të fillojmë punimet menjëherë.

**Arta Dade**: faleminderit! Po zoti Islami.

**Kastriot Islami**: kam një pyetje teknike me këtë grant që juve do merrni, cili është afërsisht numri i projekteve dhe sa përqind të ujësjellësve rural zë ky numër?

**Blendi Bushati**: synimi i programit ka qenë për një popullsi rurale gati 75000 banorë.

Ne nuk kemi në fakt një të dhënë të plotë të skemave të zonës rurale, kemi të dhëna për disa qarqe të vendit të nevojave, por nuk kemi një kuadër duke qenë se një pjesë e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve deri më sot ka mbuluar zonat urbane ose pak zona rurale rrotull dhe nuk kemi patur një pasqyrë të qartë. Edhe të dhënat nga komunat që kanë ekzistuar kanë qenë shpesh herë fragmentare. Ne kemi bere një përpjekje para 3-4 vitesh për një studim, por është i bazuar mbi disa hipoteza të cilat nuk janë të verifikuara, vlera totale për investim në zonat rurale të vendit mund të jetë në shumën e 240 milion euro, por kjo ka nevojë për konfirmim.

**Namik Dokle:** për të gjithë zonën rurale të vendit?

**Blendi Bushati**: Po. Çdo bashki do të ftohet ose do të jetë e hapur dhe transparente për të gjitha bashkitë që kanë kriteret, do të ketë kritere skualifikuese, pastaj do të bëhet në formën e një liste.

**Valentina Leskaj**: Do të thotë që nuk ka të bëjë me një plan integral fizibiliteti për të gjithë territorin por do të jetë mbi bazën e kërkesave që do të vijnë nga bashkitë.

**Blendi Bushati**: Do të jetë mbi bazën e projekteve që do të vijnë nga bashkitë.

**Arta Dade**: A kemi raste që është financuar një projekt për ndërtimin e ujësjellësit dhe në fakt kur shkon pas 2-3 vjetësh nuk gjen asgjë nga ujësjellësi. Jeni në dijeni për këto raste? Ka disa komuna të papërfillshme përpara se të bëhej reforma.

**Blendi Bushati**: përvoja që ne kemi patur kryesisht me KFW në përgjithësi ka qenë pozitive dhe ka qenë me baza të vete qëndrueshmërisë. Pra mundet që një ujësjellës të shlyej vetveten si investim dhe të jetë i menaxhueshëm. Ne i ndjekim për një periudhë disa vjeçare të paktën minimalisht çdo 6 muaj, jemi siguruar që kemi një staf shumë të mirë në njësitë vendore të trajnuar për menaxhimin e këtyre ujësjellësve. Pra stafi teknik ka qenë i përfshirë që në momentin e parë, që nga procedura e prokurimit, zbatimit, dhe pastaj janë trajnuar në mënyrë të vazhduar qoftë nga aspektet teknike të menaxhimit qoftë nga aspektet komerciale financiare si të vendosen tarifa, si t'i mbledhin. Mund të themi që në një masë të madhe sot nga raportet tona, skemat patjetër që funksionojnë, por një pjesë e madhe funksionojnë mirë dhe mbledhin tarifa.

**Arta Dade**: e kam fjalën për ujësjellësa që nuk figurojnë fare, janë vetëm në letër. Mbase nuk kanë qenë të financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe po ti shikosh aty rezulton që paratë janë dhënë por ujësjellësi nuk është ndërtuar, këtu ka një vjedhje skandaloze. Për fat të keq në disa raste dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk ka funksionuar. Ndoshta nuk janë me fondet që ju lëvroni përmes marrëveshjeve që ne kalojmë, por ka të tilla raste që janë marrë paratë për të ndërtuar ujësjellësin dhe nuk ka gjurmë fare në X fshat.

**Blendi Bushati**: ju siguroj që nuk janë me fondet tona.

**Arta Dade**: mua më vjen shumë mirë që do të jenë fondet më të kontrollueshme tani. Mbas reformës territoriale do të jenë më të përgjegjshëm si qytetarët për të kontrolluar kryetarët e bashkive sa i zbatojnë projektet dhe si menaxhohet të gjitha burimet monetare të vëna në dispozicion për t'i shërbyer qytetarëve. Po zonja Leskaj.

**Valentina Leskaj**: pyeta në do mbështetet mbi një vlerësim apo mbi kërkesat e bashkive, sepse ka raste që ka bashki që kanë kapacitete aplikojnë për projekte, por ka bashki që nuk kanë kapacitete dhe nuk aplikojnë. Në këtë rast s'behet? Sepse bëhet fjalë me furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë. Cila është qasja? Bëhet mbi bazën e projekteve të bashkive që konkurrojnë apo ka një vlerësim nga qeveria? Ka një identifikim të nevojave? Sepse nëse ka një kryetar bashkie të pa aftë kjo nuk do të thotë që banorët e asaj zone të mbeten pa ujë.

**Blendi Bushati**: desha të shpjegoj diçka në lidhje me projektin. Ky është një diskutim që ne e kemi patur të hapur me përfaqësuesit e KFW kur filloi ky program që disa bashki mund të jenë me kushte më të mira se sa të tjerat. Ideja ishte që nëpërmjet këtij granti nuk është vetëm çështja e një vështrimi të rreptë të propozimeve që sjellin bashkitë por është edhe asistencë me to. Minimalisht propozimet që ato sjellin të jenë të pranueshme. Asnjë nga bashkitë të digjet për mungesë të kapaciteteve. Mund t'i ndihmojmë që të sjellin një propozim të barasvlershëm me njëri tjetrin. E kemi bërë këtë punë për një kohë të gjatë me zonat më të disfavorshme të vendit.

Nuk kemi një këndvështrim të copëzuar vetëm nga komunat individuale por kemi mundësi që të ulemi dhe me bashkitë e reja për të bërë një vlerësim të zonës për të thënë ku janë hendeqet dhe propozimi të jetë më përfitues.

**Valentina Leskaj**: ky është shqetësimi që të ketë një vlerësim tërësor që të mos mbeten zona të caktuara të pa mbuluara për shkak të mungesës së kapaciteteve.

**Namik Dokle**: ju thatë që në tërësi duhen 240 milionë euro për të mbuluar rrjetin e ujësjellësve në Shqipëri. Përveç KFW burime të tjera financimi të ujësjellësve kush janë?

**Elona Mistrovica**: në lidhje edhe me pyetjen e parë nga Drejtoria e Përgjithshme e ujësjellës kanalizimit është përcaktuar një masterplan me disa donatorë ndër të cilët janë KFW, BERZH, me një vlerë mesatare deri në 2040 investimi që kërkohet për të rehabilituar të gjithë rrjetin e ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri, jo vetëm të zonave rurale, ka një vlere rreth 140 milionë euro në vit. Punohet për të gjetur investime.

**Namik Dokle**: domethënë KFW është ndër donatorët më të fuqishëm?

**Elona Mistrovica**: për skemat rurale po, ndërsa në total kemi të përfshirë Bankën Botërore, kredinë Austriake.

**Kastriot Islami**: në çfarë viti është bërë masterplani?

**Elona Mistrovica**: Masterplani i  përket 2012 nëse s'gaboj. Është bërë një memorandum mirëkuptimi midis donatorëve të ndryshëm, momentalisht për këtë ndërhyrje ka 70 milion euro në dispozicion. Janë të gjitha raportime nga Drejtoria e ujësjellës kanalizimeve.

**Arta Dade**: faleminderit! Kush është dakord që t'i kalohet seancës për ratifikim? Kundër? Abstenim? Miratohet!

Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 06.10.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arta Dade – kryetare e Komisionit**

**(Procesverbal i mbajtur me shënime)**

**Rendi i ditës:**

4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së RSH dhe Qeverisë së Japonisë, për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhme, miqësore ndaj mjedisit";

**Marrin pjesë:**

Arta Dade, Aldo Bumçi, Namik Dokle, Valentina Leskaj, Perparim Spahiu, Vangjel Dule, Luljeta Arapi, Eduard Selami, Kastriot Islami.

**Mungojnë***:*

Edlira Çekrezi, Ben Blushi, Jozefina Topalli, Shpëtim Idrizi.

**Të ftuar:**

1. Z. Blendi Bushati, Drejtor i Departamentit te Zhvillimit Rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
2. Z. Leonard Miloti, Përgjegjës i Njësisë se Projekteve Hidroteknike, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
3. Brikena Jazxhi - Specialiste, Ministria e Financave
4. Elona Mistrovica - Specialiste, Ministria e Financave;
5. Altina Qirjazi- Drejtoria e Shërbimeve Administrative pranë Kryeministrisë

6. Znj Pranvera Kastrati me detyre Përgjegjëse Sektori Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
7. Znj Borana Kalemi me detyre Specialiste Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
8. Z. Armand Skapi, Drejtor i Drejtorisë se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme
9. Z. Refik Golli, Specialist, Drejtoria se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme

**HAPET MBLEDHJA**

**Arta Dade**: vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së RSH dhe Qeverisë së Japonisë, për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhme, miqësore ndaj mjedisit". Zoti Skapi keni fjalën.

**Armand Skapi**: faleminderit zonja Kryetare. Sot paraqitet për diskutim Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së RSH dhe Qeverisë së Japonisë, për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhme, miqësore ndaj mjedisit".

Është një marrëveshje me shkëmbim notash ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë nëpërmjet të cilës qeveria Japoneze i akordon qeverisë Shqiptare një grant prej 500 milionë YEN ose 4 milion dollarë amerikanë. Grant i cili do të konvertohet në makina mjedisore si dhe pajisjet shoqëruese që lidhen me mirëmbajtjen e tyre. Është një marrëveshje që pavarësisht se është grant ka një detyrim financiar për Republikën e Shqipërisë, duke qenë se parashikohen termat e marrëveshjes në bazë të saj do të mbulohen të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore nga ana e Republikës së Shqipërisë. Për pasojë në bazë të nenit 121 pika ç) e Kushtetutës kjo marrëveshje i kalon Kuvendit për ratifikim. Është e rëndësishme të theksoj që zbatimi i kësaj marrëveshje do të ketë një ndikim shumë pozitiv për mjedisin duke dërguar makina të këtij lloji pikërisht në ato zona që janë të rrezikuara nga ana e ndotjes mjedisore. Marrëveshja nuk parashikon listën e makinave që do të vijnë, por kjo listë do të përcaktohet më vonë në bashkëpunim ndërmjet dy qeverive, për këtë qëllim janë përcaktuar disa nga institucionet shqiptare që do të merren me përgatitjen e listës së makinave që do të vijnë, si Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia e ofrimit të shërbimeve të integruara, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar si dhe disa institucione të tjera. Dua të theksoj se kjo marrëveshje ka patur nevojë të ratifikohet shpejt nga Kuvendit të Shqipërisë me qëllim të lëvrimit të fondeve nga ana e qeverisë së Japonisë.

**Arta Dade**: Faleminderit!

**Aldo Bumçi** Si funksionon dhënia e ndihmës? Japonezët thonë do ju japim 4 milionë dollarë makina apo ne shkojmë dhe bëjmë disa kërkesa dhe shikohet çfarë mund të arrijmë?

**Armand Skapi**: Mbi bazën e paketës që na vjen nga Ministria përkatëse. Logjikisht këto lloj marrëveshjesh diskutohen në nivele teknike ndërmjet dy qeverive, për këtë qëllim dhe nga ambasadat tona, si është rasti i Japonisë. Parashtrohen nevojat dhe e rëndësishme është të

hidhet ideja, pastaj pala Japoneze brenda mundësive dhe brenda kuadrit të saj ligjor të brendshëm parashikon edhe ndihmën që mund të japi për qeverinë Shqiptare.

**Aldo Bumçi**: atëherë kjo ka nisur nga një kërkesë e jona për t'u pajisur me makina?

**Armand Skapi**: besoj se po. Ndërmjet dy palëve do të krijohet një komision i përbashkët nga institucionet respektive, aty përcaktohet pastaj dhe lista e makinave, destinacioni ku do të shkojnë.

**Arta Dade**: çfarë do të thotë "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës me shkëmbim notash..''?

**Armand Skapi**: nga pikëpamja procedurale marrëveshjet mund të lidhen në disa forma: marrëveshje klasike që ulen përfaqësuesit e dy Qeverive të nënshkruajnë një dokument, ka dhe një marrëveshje me shkëmbim notash, që nënkupton që njëra palë i adreson më anë të një note palës tjetër, parashikohen termat e marrëveshjes, natyrisht kjo vjen pas negociatave që zhvillojnë palët, dhe pastaj pala tjetër i përgjigjet kësaj note që përmban tekstin e marrëveshjes së plotë. Kjo është një formë shumë e njohur. Është një praktikë që aplikojmë kryesisht me palën japoneze për shkak të largësisë, mungesa e kontakteve të shpeshta.

**Aldo Bumçi**: Mua nuk më duket serioze që Qeveria Shqiptarë të kërkojë ndihmë për makina. Nëse problemet e këtij vendi janë mungesa e makinave dhe ne i kërkojmë ndihmë Japonisë të na sjellë makina kjo për mua nuk është e përgjegjshme. Ju marr dy shembuj ne kemi përmbytje në Shqipëri kishim në Fier, Vlorë vjet, kishim në Lezhë, ketë vit po ripërsëriten shpresoj mos jetë një dimër i vështirë.

Ministria e Bujqësisë me shkurtimet që ju bënë buxhetit para një muaji janë shkurtuar rreth 5milione dollarë ne investime kanalizimi, do të ishte më mirë të kërkonim investime në projekte kundër përmbytjes se sa të blejmë makina. Edhe sektorë të tjerë mund të kenë nevoja, por një qeveri e përgjegjshme nuk kërkon makina. Kërkon ndihmë për fusha jetike që prekin qytetarët. Ju sugjeroj që këto makina të jenë ambulanca se sa të vijnë makina për shërbimin qeveritar.

**Arta Dade:** po zonja Qirjazi.

**Altina Qirjazi**: jam koordinatore në drejtorinë e programimit të zhvillimit, financimit dhe ndihmës së huaj, mbuloj disa donatorë.

Na u ofrua mundësia për të aplikuar për një grant Japonez gjë që jepet shumë rrallë dhe nuk donim ta humbisnim me çdo kusht. Na u ofrua një grant prej 500 milionë jenësh ose rreth 500 milionë lek, ose 4 milionë dollarë. Qëllimi i këtij granti ishte reduktimi i gazrave që shkaktojnë efektin serë, zvogëlimin e ndotjes mjedisore nëpërmjet promovimit të makinave të gjeneratës së re miqësore ndaj mjedisit. Këto makina do të shërbejnë në nxitjen dhe

ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore dhe publikut për të përmirësuar cilësinë dhe performancën mjedisore. Makinat do të shfrytëzohen për përdorim publik. Në përputhje me nevojat e sektorit publik për mjete transporti. Do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve publike, optimizimin e shërbimeve mbështetëse të administratës për institucionet qeveritare, rritjen e mobilitetit të institucioneve monitoruese mjedisore dhe zbatimin e planeve të veprimit për rehabilitimin e zonave te dëmtuara mjedisore. Rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e mjedisit si dhe reduktimin e ndotjes së ajrit. Këto janë synimet kryesore.

Marrëveshja në vetvete nënkupton lidhjen e një marrëveshje midis qeverisë Japonisë dhe qeverisë Shqiptare për pranimin e këtij granti nga ana jonë për furnizimin me makina miqësore ndaj mjedisit. Tipet e makinave të ofruara në momentin e aplikimit kanë qenë hibride, me disel të pastër, elektrike ose të kombinuara. Në implementimin e projektit do të kemi parasysh që tipin, llojin e makinave, specifikime teknike do t'i përcaktojmë në mënyrë të përbashkët, nëpërmjet një këshilli ndërinstitucional, plus agjencinë japoneze për prokurimet.

**Arta Dade**: institucionet që do të përfitojnë nga ky grant?

**Altina Qirjazi**: ne i përcaktuam në përputhje me nevojat madhore që ka qeveria për mjete transporti sidomos për institucionet në varësi të Ministrisë së Mjedisit, të INUK-ut, të Shërbimeve Publike. Në një moment të dytë do të kemi dhe një kalendar të qartë të shpërndarjes së këtyre makinave.

**Arta Dade**: kolegë pyetje?

**Aldo Bumçi**: kisha dy pyetje. Unë besoj që në fazën që janë bërë negocimet mendoj që nevojat e këtij vendi janë të tjera dhe jo makinat. Përmenda përmbytjet, mund të kishin qenë fonde për përmbytjet të cilat përsëriten çdo vit. Pra pse nuk është kërkuar granti për një fushë tjetër më të rëndësishme për vendin.

E dyta nëse ata kishin një qëllim pse jo ambulanca për spitalet e Shqipërisë?

**Altina Qirjazi**: në momentin që bëmë aplikimin patëm parasysh edhe nevoja të këtij tipi, sidomos makina të mëdha për të kryer punime ndoshta, por nuk ofrohen makina të tilla vetëm autovetura, prandaj menduam se mund t'i shfrytëzonim për këtë. Ka por nuk ofroheshin.

**Arta Dade**: kolegë kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet!

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 06.10.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arta Dade – kryetare e Komisionit**

**(Procesverbal i mbajtur me shënime)**

**Rendi i ditës:**

5. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së konsulencës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare";

**Marrin pjesë:**

Arta Dade, Aldo Bumçi, Namik Dokle, Valentina Leskaj, Perparim Spahiu, Vangjel Dule, Luljeta Arapi, Eduard Selami, Kastriot Islami.

**Mungojnë***:*

Edlira Çekrezi, Ben Blushi, Jozefina Topalli, Shpëtim Idrizi.

**Të ftuar:**

1. Z. Blendi Bushati, Drejtor i Departamentit te Zhvillimit Rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
2. Z. Leonard Miloti, Përgjegjës i Njësisë se Projekteve Hidroteknike, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
3. Brikena Jazxhi - Specialiste, Ministria e Financave
4. Elona Mistrovica - Specialiste, Ministria e Financave;
5. Altina Qirjazi- Drejtoria e Shërbimeve Administrative pranë Kryeministrisë
6. Znj Pranvera Kastrati me detyre Përgjegjëse Sektori Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

7. Znj Borana Kalemi me detyre Specialiste Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
8. Z. Armand Skapi, Drejtor i Drejtorisë se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme
9. Z. Refik Golli, Specialist, Drejtoria se Traktateve dhe se Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme

**HAPET MBLEDHJA**

**Arta Dade**: Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit të tretë, "Për ratifikimin e marrëveshjes së konsulencës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare";

Për të prezantuar projektligjin kemi të pranishëm; Znj Pranvera Kastrati me detyrë Përgjegjëse Sektori Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Znj Borana Kalemi me detyre Specialiste Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme që tashmë i kemi prezantuar.

Zonja Kastrati keni fjalën.

**Pranvera Kastrati**: Faleminderit! Të nderuar zotërinj dhe zonja deputete,

Kjo është një marrëveshje konsulence e cila synon mbështetjen e qeverisë shqiptare në reformat që ajo ka ndërmarrë për përmirësimin e frymës së biznesit duke patur disa dimensione brenda saj. Në vlerën e saj totale i gjithë projekti është 1 730 000 mijë dollarë nga të cilat kërkohet dhe një kontribut nga qeveria Shqiptare i cili është i ndarë në kontribut cash dhe në kontribut në natyrë. Kontributi cash është në vlerën 140 000 dollarë i cili do të ndahet në pesë këste të parashikuara në këtë marrëveshje, ndërkohë që kontributi në natyrë është kryesisht kontributi i tërë ekspertëve të administratës publike që do të jenë pjesë e kësaj marrëveshje konsulence, do të jetë në vlerën 300 000 dollarë. Marrëveshja synon mbështetjen e qeverisë Shqiptare në reformat e saj për përmirësimin e klimës së biznesit duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në përmirësimin e klimës të bësh biznes duke patur si objektiv parësor të saj mbështetjen në reformën e nisur për përmirësimin e lejeve të ndërtimit, në përmirësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet një analize të detajuar, aq më tepër që tashmë është miratuar Kodi i Procedurës Administrative dhe vijimi i konsulencës që do të japi IFC në këtë drejtim konsiderohet shumë i rëndësishëm jo vetëm për krijim e kapaciteteve por edhe për evidentimin e tëra mundësive për të lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për të krijuar kështu lehtësi për biznesin në këtë drejtim.

Në këtë kuadër do të mbështetet qeveria shqiptare në krijimin e një ndërfaqeje për regjistrimin dhe licencimin elektronik të njëkohshëm të biznesit. Si mund të jeni në dijeni ka nisur bashkimi i QKL dhe QKR dhe nëpërmjet kësaj konsulence do të vijohet më tej me mbështetjen e lehtësimit elektronik të të tëra procedurave për licencimin dhe për regjistrimin e biznesit.

Në fushën e politikës së investimeve qasja e kësaj marrëveshje konsulence është e ndarë në dy drejtime kryesore, në një mbështetje të përgjithshme në tërësi për ekonominë duke synuar në vlerësimin dhe inventarizimin në të tëra politikave dhe statusit aktual të barrierave për investimet, në mënyrë që të propozohen të tëra rekomandimet për të krijuar sa më shumë lehtësira për investitorët e huaj në Shqipëri. Fokus në këtë rast përveç politikës së përgjithshme të investimeve dhe të konkurshmërisë jepet nxitja e investimeve në sektorin e agrobiznesit dhe kjo kryesisht në sektorin e prodhimeve të freskëta dhe të përpunimit ushqimor duke patur parasysh potencialin shqiptar dhe rëndësinë që ky sektor po merr, mbështetja do të bëhet në vlerësimin e barrierave që ka për investimin në këtë sektor në mënyrë që të mundësohet dhënia e rekomandimeve për tërheqjen e investimeve të huaja në këtë sektor.

Sa i takon rregulloreve të biznesit duke qenë se Shqipëria ka punuar për vite të tëra në liberalizimin tarifor shikohet që merr përparësi lehtësimi i tregtisë, lehtësimi i procedurave të kalimit të kufirit kjo e parë në mënyrë të ndërthurur jo vetëm me procedurat doganore por dhe me procedura të tjera që lidhen me agjencitë e tjera që veprojnë në kufi, dhe fokusi në këtë rast do të jetë Agjencia Kombëtare e Ushqimit, kjo për vetë faktin që vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, kalimi i kufirit për produktet ushqimore merr rëndësi parësore për të garantuar sigurinë e produkteve në treg.

Pjesë e lehtësimit të procedurave të kalimit të kufirit fokus të veçantë kjo marrëveshje do t'i japi edhe bashkëpunimit me Kosovën dhe zbatimit të Marrëveshjes që qeveria Shqiptare ka nënshkruar tashmë me qeverinë e Kosovës për lehtësimin e procedurave të kufirit duke mundësuar kështu një thjeshtësim të mëtejshëm të atyre kërkesave që sot ka për produktet në të dyja vendet.

Përveç qasjes sektoriale që ishte sektori agropërpunimit, synohet që nëpërmjet kësaj marrëveshje të shikohet dhe të vlerësohet, të bëhet një panoramë e të tëra kërkesave që sot ka për kalimin e kufirit me partnerët kryesorë, tregtarët e Shqipërisë për të mundësuar dhe për të lejuar në mënyrë të tillë që masat e propozuara nga Qeveria Shqiptare brenda kohëzgjatjes së këtij projekti që është deri ne vitin 2019 të lejojnë lehtësira të mëtejshme dhe akses të biznesit në tregti dhe në të gjitha shërbimet publike.

**Arta Dade**: Faleminderit! Pyetje?

**Aldo Bumçi**: ne mbështesim çdo përpjekje në mbështetje të biznesit. Gjendja nga ku nis ky projekt është shumë e rëndë. INSTAT thotë që ka rënë konsumi, në krahasim me vitin që kaloi 3.1% në tre mujorin e dytë, në tremujorin e parë me 1.2 %. Vjet nuk ka qenë një vit i jashtëzakonshëm konsumi. Tkurrja e konsumit me 3% nga vjet tregon që situata është

përkeqësuar. Të dhënat e bankës së Shqipërisë janë të gjitha shumë shqetësuese, ka rënie të besimit tek konsumatorët, ka rënie besimi tek sipërmarrësit. Kjo është një klimë shumë e vështirë për biznesin, projektet janë të rëndësishme por nuk besoj se është çështje mos njohurie. Ju thatë që një nga fushat e rëndësishme të këtij projekti do të jete dhënia e lejeve të ndërtimit. E domosdoshme për të krijuar transparencë, për të shkurtuar kohën. Çfarë ka ndodhur në fushën e ndërtimit? Në dy vite ne kemi pezullim të ndërtimeve në Shqipëri. Kryeministri deklaroi që deri sa të mbarojnë zgjedhjet lokale nuk do të ketë leje të reja në Shqipëri. Pra kemi një industri të tërë të pezulluar. Unë shpresoj që ky projekt ta ndryshojë situatën por nuk kam besim. Fakti që ka mosbesim nga sipërmarrës, nga konsumatorë duhet analizuar mirë pse. Situata është mjaft e rëndë. Faleminderit!

**Arta Dade**: keni ndonjë pyetje? Ne do ta inkurajonim Ministrinë dhe të gjithë specialistët që të jenë të vëmendshëm për të arrirë transparencën në zbatimin e projekteve, të forcohen kapacitetet që gjithçka që hartohet të shkojë në dobi të qytetarëve shqiptarë.

Kolegë jeni dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet.